



Agjencia për mbikëqyrje të financimit  
kapital të sigurimit pensional

BULETINI ELEKTRONIK

**E-MAPAS**

**NR.52**

**SIGURIM PENSIONAL  
VULLNETAR  
(KURSIM NË SIGURIM  
PENSIONAL VULLNETAR)**

DHJETOR VITI 2024

Kursimi nënkupton ruajtjen e të mirave materiale ose parave për përdorim të tyre në një periudhë të ardhshme. Kursimi i parave për daljen në pension është i rëndësishëm për sigurimin e mjeteve për të jetuar në pleqëri. Kursimi në fond pensioni vullnetar është mënyra më e mirë për të siguruar fonde në moshë më madhore, aq më tepër nëse është shtesë në sigurimin e detyrueshëm pensional.

Fitimet nga sigurimi pensional vullnetar:

1. Pavarësi financiare në ditën e pensionit Sigurimi pensional vullnetar është mundësi për të kursyer fonde për pension ose fonde shtesë që e zmadhojnë standardin e jetesës pas përfundimit të jetës së punës.
2. Fleksibilitet në pagesa. Anëtarët kanë mundësinë të planifikojnë shumën dhe shpeshtësinë e pagesave sipas mundësive të tyre.
3. Rritja afatgjatë e mjeteve në fondet e pensioneve investohen në tregjet financiare, gjë që siguron akumulimin dhe zmadhimin e mjeteve të paguara.
4. Trashëgimia e kursimeve. Në rast vdekjeje të anëtarit të fondit pensional, kursimet trashëgohen nga trashëgimtarët.

Kursimi në sigurimin pensional vullnetar fillon me anëtarësimin në një nga shoqëritë pensionale dhe anëtarësimin në fond pensional vullnetar.

Anëtarësimi në fondet pensionale vullnetare

Anëtar i fondit pensional vullnetar mund të jetë çdo person që ka mbushur moshën 15 vjeç dhe është pronar i një llogarie individuale vullnetare ose pjesëmarrës në një skemë pensionesh profesionale me llogarinë e tij profesionale. Anëtar i mund të paguajë një kontribut vullnetar për veten e tij, ose mund ta bëjë për të një palë e tretë (paguese) ose sigurues që financon skemë pensionesh profesionale.

Personi bëhet anëtar i një fondi pensioni vullnetar si në vijim:

- Me nënshkrimin e marrëveshjes për anëtarësim dhe me hapjen e llogarisë individuale vullnetare.
- Me pjesëmarrjen në skemë pensionale profesionale dhe me hapjen e llogarisë profesionale nga një punëdhënës.

**KURSIMI NË RINI ËSHTË  
THEMELI I NJË  
PLEQËRIE DINJITOZE**

**ANONIM**

**ATË QË E KURSENI SOT  
DO T'JU MBROJË NESËR.**

**ANONIM**



Shoqëria që administron fondin pensional hap llogari menjëherë pas pagesës së parë të fondeve. Një person mund të ketë vetëm një llogari individuale vullnetare dhe një llogari profesionale, të cilat mund të jenë në të njëjtin fond pensioni vullnetar ose të ndryshëm.

### Pagesa dhe investimi i kontributeve vullnetare

Mjetet paguhen në llogarinë e anëtarit të fondit pensional vullnetar.

Anëtari, paguesi ose siguruesi (punëdhënësi) përcaktojnë lirisht shumën dhe dinamikën e pagesave, kurse ndërprerja ose ndryshimi i shumës së pagesave nuk cenon të drejtën e anëtarësimit dhe frytëzimit të fondeve. Kontributet në fondin pensional vullnetar investohen në instrumente financiare me qëllim arritjen e kthimit më të lartë në favor të anëtarëve dhe menaxhimin e riskut, duke rritur kështu kursimet për pension.

### Pagesa e mjeteve nga sigurimi pensional vullnetar

Fondet e kursyera në sigurimin pensional vullnetar mund të tërhiqen jo më vonë se dhjetë vjet para moshës për fitimin e të drejtës për pension pleqërie. Fondet mund të tërhiqen në mënyrë të njëfishtë, disa herë, si pension vjetor ose tërheqje të programuara ose një kombinim i këtyre dy llojeve.

### Përfundim

Sigurimi pensional vullnetar është instrument i rëndësishëm për stabilitetin dhe sigurinë financiare. Me mundësinë e pagesave fleksibël dhe menaxhimin profesional të fondeve nga shoqëritë e pensioneve, kjo formë kursimi është thelbësore për sigurimin e një pleqërie dinjitoze. Planifikimi në kohë dhe pagesat e rregullta mund të kontribuojnë ndjeshëm në përmirësimin e standardit të jetesës në vitet e pensionit.



## NJOFTIM PËR NGJARJEN “MIRË SE VINI BRUCOSHË – ORA E PARË AKADEMIKE E UKIM”

Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional – MAPAS së bashku me shoqërit pensionale KB shoqëria e parë pensionale, SAVA shoqëria pensionale a.d. Shkup dhe TRIGLAV shoqëria pensionale ad Shkup mori pjesë në ngjarjen për fillimin e vitit të ri akademik për të gjithë brucoshët e Universitetit “Shën Kirili dhe Metdij” (UKIM).

Për më shumë informacione vizitoni [linkun](#) e mëposhtëm.



## KOMITETI PËR STABILITETIT FINANCIAR: ËSHTË RUAJTUR STABILITETI FINANCIAR

Pavarësisht shumë krizave, stabiliteti i sistemit financiar është ruajtur, ndërsa rreziqet kanë mbetur në nivele të moderuara. Vitin e kaluar, institucionet financiare kanë punuar në mjedis makro më të favorshëm dhe arritën rezultate solide dhe thelluan ndërmjetësimin financiar. Megjithatë, ka ende rreziqe dhe pasiguri që lidhen kryesisht me mjedisin e jashtëm dhe ndikimin e trazirave gjeopolitike dhe fragmentimit gjeo-ekonomik. Këto janë një pjesë e konstatimeve nga mbledhja e sotme e Komitetit për Stabilitet Financiar, që u mbajt në Bankën Popullore.

Për më shumë informacione vizitoni [linkun](#) e mëposhtëm.



## EDICIONI I TETË I DITËVE TË EDUKIMIT FINANCIAR 26-28 NËNTOR 2024

Nga data 26 deri më 28 nëntor të këtij viti do të mbahet edicioni i tetë i ditëve të edukimit financiar i organizuar nga institucionet rregullatore financiare: Banka popullore, Ministria e financave, Komisioni i letrave me vlerë, Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional – MAPAS dhe Agjencia për mbikëqyrjen e sigurimeve, së bashku me sektorin financiar privat.

Për më shumë informacione vizitoni **linkun** e mëposhtëm.



**KENI PYETJE OSE ANKESA?**  
Paraqituni në MAPAS ose shkruani një mesazh në  
[contact@mapas.mk](mailto:contact@mapas.mk)

Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional (MAPAS)  
Slavko Janevski 100, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut  
Tel: (02) 3224 229  
[www.mapas.mk](http://www.mapas.mk)



[www.mapas.mk](http://www.mapas.mk)



[mapas.mk](https://www.facebook.com/mapas.mk)



[mapas.mk](https://www.instagram.com/mapas.mk)



[mapasmk](https://www.linkedin.com/company/mapasmk)